



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
GJUHË SHQIPE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____

VENDI _____

KOMUNA _____


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <http://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra tetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit:

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për të plotësuar testin në dispozicion ke **120 minuta**.
- Shkruaj mirë, në mënyrë që shkrimi të jetë i lexueshëm, duke pasur kujdes që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, të shkruara sipas rregullave drejtshkrimore dhe gramatikore.
- Kur të zgjedhësh detyrat tek të cilat duhet të shkruash diçka, gjithmonë përdor emërtimet e plota; shkurtesat nuk janë të lejueshme (p.sh. duhet të shkruash emri, e jo em., ose gjinore e jo gjin., ose të shkurtesa tjera të ngjashme)
- Plotëso testin me **laps kimik ngjyrë të kaltër** (gjatë punës mund të përdorësh laps të thjeshtë grafik dhe gomë).
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps të thjeshtë grafik, laps kimik ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Bëj kujdes, sepse detyrat dallojnë për nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet () , të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat ku ekzistojnë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
<input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevc	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrethët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
<input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5	

- Nëse përfundon më herët testin se sa koha e paraparë, dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

TESTI GJUHË SHQIPE

1. Çfarë lloj i tekstit është teksti i dhënë:

Pushimet mbaruan

Pushimet mbaruan ...Uji i liqenit të Pogradecit tashmë është ftohur. Dielli nuk djeg më dhe dita ka filluar të shkurtohet."Sot është mëngjesi i kthimit", mendoi Drini. Pastaj ai, Ela e Andi zbresin poshtë. Përqafohen me gjyshërit dhe ulen në ndenjëset e prapme të makinës. Bagazhi i saj mbushet plot. Edhe babai e mamaja hipin në makinë.

- Mirupafshim, mirupafshim!..- thëret Drini.

- Udhëtim të mbarë! Ejani përsëri!

Në zërin e gjyshërve ndihet trishtim. Makina nisat dhe futet në kthesën e gjerë, ku ndodhen vilat e reja. Në mes të sheshit është një shatërvan shumë i bukur. Nga shatërvani del ujë i pastër si kristal . Vendi ku qëndron shatërvani është ngjyrë gri i hapur dhe i ngritur nga toka. Rrethi i tij është një lëndinë e gjelbëruar, ku fëmijët loznin e freskoheshin në ditët e nxehta të verës.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Tekst letrar
- Tekst joletrar

2. Bashkëtingëlloret që përbëhen vetëm prej zërit quhen bashkëtingëllore të tingullta.

Trego cilat janë duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë.

- m, n, nj, j, r, rr, l, ll
- k, g, h, j
- b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh

3. Cila nga fjalët është shkruar gabim?

Ngjyros rethin para përgjigjes së saktë.

- kurrëkush
- gjithsecili
- kurrkund
- gjithnjë

4. Përcakto llojin e formës së pashtjelluar të foljes në fjalinë e mëposhtme.

Anila shëtiste çdo pasdite në park duke dëgjuar muzikë.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Përcjellorja
- Paskajorja
- Pjesorja

5. Në çfarë marrëdhënie të ndërsjellë janë fjalët:

i bardhë – i zi
i gjatë – i shkurtë
e hapur – e mbyllur

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- sinonimike,
- antonimike,
- homonimike

6. Kur dhe ku u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- më 1908 në Manastir
- më 1972 në Tiranë
- më 7 mars 1887 në Korçë

7. Ngjyros rrethin poshtë titullit të veprës duke lidhur me autorin i cili e ka shkruar atë.

	Lulet e Verës	Kështjella	Gavroshi	Lutjet e mbrëmjes
Ismail Kadare	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Viktor Hygo	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Anton Pashku	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Naim Frashëri	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

8. Lexo me kujdes vargjet:

Sa dëshiroj

- Sa dëshirë kam të kthehem në argjend,
o nëna ime zefir,
kjo dëshirë në shpirt po më çmend...
- Rri kështu siç je, o bir.
- Sa dëshiroj të kthehem në lumë,
o nëna ime safir,
kjo dëshirë më lë natën pa gjumë...
- Rri kështu siç je, o bir.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Në vargjet e më sipërme poeti ka përdorur rimën e:

- e mbyllur
- e përputhur
- e kryqëzuar

9. Teksti i paraqitur është:

Matia dhe gjyshi

- Kam frikë mos të të humb,kaq i vogël sa je bërë. Të vendos në xhep!
- Tani për tani më mbaj në grushtin e mbyllur dhe të shkojmë në shtëpi. Do ta shohësh, do ta gjejmë zgjidhjen.
- Po pra,është vonë. Dhe pak më tej.
- Nëpër rrugën përgjatë lumit ka shtylla ndriçimi, gjysh.....
- Mirë, kështu ecet më lehtë, Matia...

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Monolog
- Përshkrim
- Dialog

10. Fjalitë e paplota që organizohen logjikisht me anë të intonacionit dhe mbështeten fuqishëm me gjeste e mimikë janë karakteristikë e gjuhës së folur.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë

- E saktë
- E pasaktë

11. Cilat nga fjalitë e dhëna më poshtë nuk është e shkruar drejt?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Fliste për vendet ku kanë udhëtuar.
- Ata e pëlqyen tepër këtë histori.
- Ç'kuptim kish fjala e kësaj fjalie?

12. Lexo me kujdes tekstin e dhënë dhe përgjigju në vijat bosh.

Populli thotë se në një fshat, aty rrëzë malit, gjendej një çezmë mbushnin ujë të gjithë njerëzit e fshatrave përreth. Çezma e kishte ujin e kulluar si argjendi e të ftohtë brisk. Një mbrëmje, një nuse që sapo ishte martuar në këto fshatra, e mbushi e fundit ujë në këtë çezmë dhe harroi që ta mbyllte. Kështu që për gjithë naten rodhi aq shumë ujë, saqë e mbushi fushëgropen plot epërplot. Prej kësaj çezme u formua liqeni dhe, sipas emrit të vendit, Prespë u quajt liqeni i Prespës. I ra mjegulla Bunës dhe e mbuloi të tërë. Kjo mjegull mbeti aty tre ditë e tre netë. Pas tri ditësh e tri netësh fryu një erë e hollë dhe e lartoi mjegullën. E lartoi dhe e shpuri gjer në kodrën e Valdanuzit. Aty majë kodrës punonin tre vëllezër. Ndërtonin një kështjellë. Murin që e bënë ditën u prishej natën dhe kështu nuk e lartnin dot.

Na shkon aty një plak i mirë.
- Puna e mbarë, o tre vëllezër.

- Të mbarë paç o plak i mirë. Po ku e sheh ti të mbarën tonë.
Ditën punojmë, natën prishet. A di të na thuash një fjalë të mirë? Ç'të bëjmë që të mbajmë muret në këmbë?
- Unë di - u thotë plaku - po e kam për mëkat t'ua them.
- Atë mëkat hidhe mbi kryet tona, se ne duam që ta qëndrojmë më këmbë këtë kështjellë.

Teksti i dhënë është _____ titulli _____

13. Në cilën rrokje bie më shpesh theksi në gjuhën shqipe.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Në gjuhën shqipe theksi më shpesh bie:

- në njërën nga dy rrokjet e fundit të fjalës
- në rrokjen e tretë të fjalës
- në rrokjen e katër të fjalës

14. Përcakto kohën, vetën dhe zgjedhimin e foljes **pinte**.

Koha _____;

Veta _____;

Zgjedhimi _____.

15. Kuptimi i shprehjes frazeologjike **heq të zitë e ullirit** do të thotë:

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- u lodh
- heq bërthamën e ullirit
- vuajti shumë

16. Trego emrin e autorit që shkroi poezinë dhe llojin e gjinisë letrare që i përket.

Vdekja e Nositit

Me zjarr ju flasme zjarr
Në gjirin tim kam hapur varr...
Që t'i jap shpresë edhe t'ja marr...

Un' ik liqerit zemërak
Fatlum dh' i pastër si zëmbak ,
Po zemra ime kullon gjak

Autori _____

Gjinia letrare _____

17. Trego cila figurë letrare është përdorur në vargjet e dhëna.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Retë marrin frymë.... lumi ikën me fishkëllimë...nata lind në errësirë.

- Metafora
- Krahasimi
- Personifikimi

18. Si quhet ndërrimi i zanoreve:

Ndërrimi i zanores a/e si tek shembujt e dhënë dash – desh, plak – pleq, natë - net, marr-merr.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- metafofi
- metatezë
- palatalizim

19. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Fjalët e nënvizuara te fjalia "Të rrethuar **nga rrufe e dallgë**, ne s'dinim se ku iku toka" kryejnë funksionin e:

- rrethororit të mënyrës
- kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë
- rrethororit të vendit

20. Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

Hiperbola është:

- figure stilistike me anën e së cilës sendit (ose kafshës) i vishen tiparet e njeriut, gjërat pa shpirt e pa vetedije paraqiten sikur mendojnë,veprojnë e flasin si njerëz.
- vënia ballë për ballë e dy anëve, dy gjendjeve, dy pamjeve, dy dukurive të kundërta, që të dalë më shprehës e më në pah mendimi i autorit.
- figurë stilistike, që ndërtohet mbi bazën e zmadhimit jashtë mase deri në tepri të qenieve, sendeve a tipareve te tyre, për të bere përshtypje ose për të theksuar mendimin.

FAQE E ZBRAZËT

FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
GJUHË SHQIPE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR